



UNMIK/DIR/2008/3
26 mars 2008

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2008/3

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/19 MBI
DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME
PËR VETËQEVERISJE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 8 të Rregullores së ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë,

Duke marrë parasysh nenet 3 dhe 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 dhe Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/36 të datës 22 dhjetor 2001 mbi Shërbimin Civil në Kosovë,

Pas konsultimit me Qeverinë dhe marrjen e pëlqimit të saj,

Me qëllim të themelimit të Qendrës kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim për të avancuar kushtet për trajnimin e shërbyesve civil të Kosovës të punësuar në fushat që lidhen me sigurinë publike, në pajtim me standardet profesionale dhe praktikat më të mira,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1

Qendra kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim

1.1 Themelohet Qendra kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim (më tutje: “QKSPAZH”) si Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tutje: “Ministria”).

1.2 QKSPAZH do të jetë institucioni primar përgjegjës për sigurimin e trajnimit të detyrueshëm të shërbyesve civil të Kosovës, të punësuar në fushat që lidhen me sigurinë publike, mes tjerash, shërbimi policor, shërbimi korrektues, shërbimi doganor dhe shërbimet e emergjencës, duke përfshirë shërbimet e zjarrit. Kjo Qendër do t’i kryej funksionet e saj duke u bazuar në ligjshmërinë, efikasitetin, përgjegjshmërinë dhe paanshmërinë.

1.3 Buxheti i QKSPAZH do të sigurohet nga Ministria dhe, sipas nevojës, mund të plotësohet me fonde të donatorëve.

Neni 2 Funksionet dhe përgjegjësitë

2.1 Funksionet dhe përgjegjësitë e QKSPAZH përfshijnë si vijon:

- (a) Sigurimin dhe mbrojtjen e arsimit teknik, zhvillimit të kurikuleve dhe shërbimeve mbështetëse për trajnime mbi sigurinë publike;
- (b) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve që janë adekuate për të përmbushur trajnimin mbi sigurinë publike dhe standardet e obligueshme për arsim;
- (c) Koordinimin e trajnimit mbi sigurinë publike dhe aktivitetet arsimore, në bashkëpunim me ministritë dhe komunat përkatëse;
- (d) Zhvillimin e një plani strategjik afatgjatë për administrimin efektiv dhe efikas të QKSPAZH;
- (e) Ofrimin e shërbimeve për Sekretariatit dhe shërbimeve të tjera mbështetëse lidhur me këtë Sekretariat Bordit kosovar mbi standardet e sigurisë publike dhe arsimin dhe
- (f) Të vepruarit si institucion kërkimor për zhvillimin e trajnimit mbi sigurinë publike dhe arsimin në Kosovë, në pajtim me standardet profesionale dhe praktikat më të mira;

- (g) Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për të gjithë studentët dhe llojet e trajnimeve dhe arsimin që atyre u është ofruar;
- (h) Koordinimin e programeve të donatorëve për trajnimin mbi sigurinë publike, arsimin dhe zhvillimin.

Neni 3

Emërimi dhe përgjegjësitë e kryeshefit ekzekutiv

- 3.1 QKSPAZH do të menaxhohet nga kryeshefi ekzekutiv, i cili është shërbyes civil në kuptim të nenit 1(j), (ii) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/36, dhe ai do të emërohet nga Komisioni për emërimet të larta publike, në pajtim me ligjin në fuqi.
- 3.2 Kryeshefi ekzekutiv i përgjigjet Ministrit të Punëve të Brendshme.
- 3.3 Kryeshefi ekzekutiv është përgjegjës për të:
 - (a) Siguruar që funksionet e besuara QKSPAZH të implementohen si duhet;
 - (b) Organizuar QKSPAZH dhe për të nxjerrë vendime dhe udhëzime administrative mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me funksionet dhe përgjegjësitë e saj;
 - (c) Menaxhuar resurset e siguruar për QKSPAZH në mënyrë efektive dhe efektive;
 - (d) Implementuar politika jodiskriminuese për personelin në QKSPAZH, duke përfshirë edhe përfaqësimin e barabartë, në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe për të siguruar që përbërja e stafit reflekton karakterin shumetnik të Kosovës;
 - (e) Plotësuar vendet e punës në QKSPAZH dhe për të siguruar që rekrutimi i stafit është i bazuar në kualifikimet profesionale, aftësitë e tyre dhe meritat dhe se rekrutimi bëhet përmes konkursit të hapur dhe të drejtë, në pajtim me ligjin në fuqi;
 - (f) Përgatitur raportin vjetor mbi punën e QKSPAZH, i cili raport i dorëzohet Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Bordit kosovar mbi standardet e sigurisë publike dhe arsimin.

- 3.4 Kryeshefi ekzekutiv do të caktojë një zyrtar të autorizuar financiar për QKSPAZH. Duke vepruar nën autorizimin e kryeshefit ekzekutiv, zyrtari i autorizuar financiar është përgjegjës për të siguruar përputhshmërinë me vendimet, me udhëzimet administrative dhe me rregullat financiare të nxjerra nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave apo nga autoritetet tjera përkatëse.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 26 mars 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm